



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

KPK/Nr. 853/2022

Datë: 29 korrik 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 29 korrik 2022, nxjerr këtë:

**VENDIM**

- I. Znj. Luljeta Bilalli, prokurore në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, transferohet në mënyrë të përhershme në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë nga data 15 gusht 2022.
- II. Obligohet znj. Luljeta Bilalli që të koordinohet me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Ferizaj për përfundimin e lëndëve të cilat i ka në punë.
- III. Znj. Luljeta Bilalli ka të drejtë në beneficionet që dalin nga ushtrimi i detyrës së prokurorit në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore.
- IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në Ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Znj. Luljeta Bilalli;
- Kryeprokurorëve P. Th. Ferizaj dhe P. Th. Prishtinë;
- Sekretariatit të KPK-së;
- NJSHPP;
- Arkivot të KPK-së.